

Tryezë diskutimi - Siguria dhe Mbrojtja e Shëndetit në Punë



Prishtinë 28 tetor 2011 - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Fondacioni Friedrich Ebert (FES) në bashkëpunim me Shoqatën Kosovare për Mbrojtje në Punë – KOSHA, më 24 tetor 2011 në Hotel Prishtina, organizuan Tryezë diskutimi që kishte të bëjë me fushën e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në vendet e punës. Me këtë rast Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale shpalli “Javën Kosovare të Sigurisë dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë”, ku fokus i Inspektoratit të Punës do të jetë kjo fushë e rëndësishme për shoqërinë kosovare.

Fushata e Ministrisë së Punës, kishte për qëllim sensibilizimin dhe marrjen e masave të nevojshme nga ana e punëdhënësve dhe punëmarrësve për ngritjen e nivelit të sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Në këtë Tryezë, krahas përfaqësuesve të BSPK-së, ishin të ftuar edhe përfaqësues të Qeverisë, Inspektoratit të punës, Shoqëritë Civile dhe ekspertë të lëmive të ndryshme. Tryeza kishte për qëllim të analizojë gjendjen aktuale dhe sfidat për arritjen e standardeve evropiane të sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

Basri Ibrahim, kryeinspektor në Inspektoratin e Punës, tha që Inspektorati i punës i bazuar në raportet e ONP-së për gjendjen e vdekshmërisë së punëtorëve në vendet e punës tha se në vitin 2008 janë shënuar 8 raste të vdekjeve në vendin e punës, në vitin 2009 -11 raste, 2010 -10, dhe 2011 deri më tani 5 raste. Numri i vdekjeve të lëndimeve në vendet e punës është në rritje, kryeinspektori Ibrahim, diskutoi për rëndësinë e raportimit të dëmeve në rast se nuk lajmërohen lëndimet në vendin e punës.

Kryeinspektori i njoftoi të pranishmit për ligjin e ri mbi sigurimin shëndetësor i cili do të aprovohet së shpejti. Kryetari i BSPK-së, Haxhi Arifi i konsideron shqetësuese rastet e vdekjes dhe lëndimeve në vendin e punës për shkak të kushteve të këqija. Sipas tij, gjendjen e sigurisë do ta zbus aplikushmeria e ligjeve të caktuara. Arifi, kërkoi një bashkëpunim më të afërt në mes të partnerëve social. Ai gjithashtu si mungesë të sigurisë dhe shëndetit në punë e shef sektorin informal të përjashtuar edhe nga mbështetja ligjore; aplikueshmerinë e ligjeve ekzistuese; funksionimin e gjyqësorit; mungesën e trajnimeve ku është më se e nevojshme e që lidhet me këtë çështje.

Lek Musa nga Oda Ekonomike Amerikane (OEA) tha se OEA, çështjes së sigurisë dhe shëndetit në punë i ka kushtuar vëmendje të posaçme. Sipas Lekës, gjendja e sigurisë dhe shëndetit në punë në Kosovë nuk është edhe e kënaqshme nga shumë arsye, e në radhë të parë ceku se pas zhvillimit ekonomik, privatizimit i cili pastaj rezultoi me problemin e papunësisë dhe përqindjen e lartë të papunësisë e cila është alarmante, pastaj sektorin joformal që nuk mund të kontrollohet, punëtorë të paevidentuar, qeveria duhet të jetë krijatori i formimit të vendeve të punës, neglizhenca e gjyqësorit dhe zgjedhja e lëndëve gjyqësore, roli i qeverisë në mbikëqyrjen e standardeve ndërkombëtare etj.

Ndërsa Blerim Sylja, kryetar i FSSHK-së për përmisimin e gjendjes së sigurisë dhe e shëndetit në punë e shef të nevojshëm, një organizim më të mirë sindikal dhe respektimin e partnereve social dhe gjithëherë me rastin e hartimit të ligjeve prezentë duhet të jetë edhe sindikata me ofrimin e mekanizmave gjegjëse. Ai kritikoi edhe mos ekzistimin informativ shëndetësor.

Në fund të këtij diskutimi, u shtrua si nevojë që të punohet për: Ngritjen e vetëdijes së të punësuarve ashtu edhe punëdhënësve lidhur me çështjen e zbatimit të ligjeve përkatëse, Punësimin e mjekëve të punës, Organizim më të mirë sindikal, Kontrollim sistematik mjekësor, Formim të databazës, Rregullimin e evidencës, Marrja e veprimeve senzibilizuese lidhur me çështjen, Organizimi i trajnimeve dhe bashkëpunimi në mes të partnerëve social. ***